



Planuar / Doretuar Punjenol/Prodato Received/Delivary	15.04	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHK	2185/2022		113	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.204/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.204/2022 të datës 03.03.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin e përfaqëson Avokate

Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “kompensim material”, kundër organit të punësimit Komuna e Dragashit, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.204/2022 e datës 03.03.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi ka qenë i punësuar në Komunën e Dragashit sipas ndryshim dhe plotësim të akt emërimit të datës 01.04.2013 në vendin e punës “Bashkëpunëtor Profesional për Zhvillim” në Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvill, dhe me datë 04.04.2019 Kryetari i Komunës merr vendim me të cilin i përlundon marrëdhënia e punës nga data 10.11.2020 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, ndërsa me datë 01.12.2020 merr vendim për kompensimin e pagesës në shumë prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit me rastin e pensionimit.

Ankuesi me datë 19.02.2021 parashtron ankesë tek Zyra e Personelit në Komunën e Dragashit dhe tek Komisioni për Parashtresa dhe Ankesa, me pretendim ankimor për pagesën e dy (2) pagave mujore dhe tri (3) pagave jubilarë me rastin e shkuarjes në pension. Pasi që ankuesi merr përgjigje lidhur me kërkesën e tij me datë 08.04.2021 parashtron padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 13.10.2021 merr Aktvendimin me numër A.nr.804/2021 me të cilin aktvendim kthehet në plotësim padia e paditësit për plotësim të padisë të datës 08.04.2021 dhe paralajmërohet paditësi që të bënë precizimin e padisë dhe Gjykatës ti dorëzoj dëshmitë mbi shtjerrimin e mjeteve juridike në procedurën administrative.



Pas marrjes së njohlimit të datës 22.02.2022 nga Udhëheqësi i Personelit përfaqësuesja e ankuesit Avokate me datë 03.03.2022 parashtroi ankesën me numër të protokollit 1140/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 07.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Komunën e Dragashit. Më datë 31.03.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Dragashit me provat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/8.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e ankuesit të datës 03.03.2022 të parashtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Kundërshtimi i paditësit i datës 03.02.2022; Autorizimi për përfaqësim; Shkresa e Udhëheqësit të Personelit; Kërkesa e datës 19.02.2021; Vendimi i Kryetarit të Komunës i datës 04.04.2019; Vendimi i datës 01.12.2020 i Kryetarit të Komunës; Flete tërheqja nga Banka BPB e datës 06.01.2021; Aktvendimi i datës 13.10.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Lista e pagave; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit e datës 01.04.2013; Kontrata e punës me numër A125 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtuara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se me rastin e pensionimit punëdhënësi është i detyruar që t'ia paguaj dy paga mujore dhe tri pagave jubilarë me rastin e pensionimit sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, e i cili pretendim ankimor i ankuesit është i pabazuar, sepse për kompensimet e nëpunësve civil janë të aplikueshme dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe aktet tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe në bazë të këtij ligji nëpunësve civil me rastin e pensionimit ju takon kompensimi në vlerën e një page të njëhershme të pagës së fundit, e jo tri (3) pagave siç ankuesi pretendon, e kjo është e përcaktuar me dispozitat ligjore të nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafin 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil që nëpunësi civil ka të drejtë të kompensohet me rastin e pensionimit dhe të dispozitave të nenit 19 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, që përcakton se: **“1. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit. 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit”.**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar që ankuesi ka pasur të drejtë të parashtroj kërkesën për pagesën e shpërblimit jubilar pas arritjes së kohës **„prej dhjetë (10) vjetësh pune”** ashtu siç është përcaktuar saktë me dispozitat e nenit 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, ku është përcaktuar që: **„Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune”**, e që nënkupton që kjo kërkesë është paraqitur jashtë afatit ligjor, pasi që ankuesi këtë kërkesë ka pasur të drejtë të parashtroj brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur e ka arritur kohën **„prej dhjetë (10) vjetësh pune”** pandërprerë në Komunën e Dragashit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit se me ligjin e punës dhe Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës sipas nenit 52 dhe 53 me rastin e pensionimit i takojnë dy paga mujore dhe tri pagave jubilarë dhe Kolegji ka konstatuar se, Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në



Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017.

Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Kryetari i Komunës së Dragashit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 01.12.2020 për kompensimin e pagesës në shumë prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit me rastin e pensionimit të ankuesit është i ligjshëm dhe i drejtë sepse është nxjerre në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë dhe Kolegji në bazë provave të lëndës ka konstatuar se ankuesit iu është bërë pagesa dhe atë në vlerë prej 450 Euro (katërqind e pesëdhjetë Euro) në bazë të Flete tërheqjes nga Banka BPB e datës 06.01.2021.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.204/2022**

Valentina Naçandolli BEKTESHI

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses së ankueses Avokate
- Kryetarit të Komunës së Dragashit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Dragashit;
- Arkivit të KPMSHCK- së.

